

VENDIM
Nr. 12, datë 13.6.2012

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME LUSHNJË

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë...”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për efekt të mbarimit të afatit operatorit sh.a. ujësjellës-kanalizime Lushnjë me:

Drejtues ligjor: z. Albert Loni Divjaka

Drejtues teknik: z. Arben Vasil Ndrecka

2. Operatori sh.a.UK Lushnjë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Lushnjë, komuna Dushk, fshati Golem.

4 Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datë 13.6.2016.

KRYETARI
Avni Dervishi